- ❖ VKM nr.328 datë 31.05.2023”Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”
- ❖ VKM nr.350 datë 19.04.2019 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”
- ❖ VKM nr.175, datë 8.3.2017 I ndryshuar ,VKM nr.241 datë 20.04.2023 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”

Në mënyrë analitike përlllogaritjet e fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numri i punonjësve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Programet Buxhetore	Nr. i punonjësve		Fondi i Pagave		Fondi Sigurimeve		Totali		Difere nce
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	
Administrata e Bashkisë dhe njësitë Administrative	126	129	64,770	97,206	11,286	15,138	76,056	112,344	
Policia Vendore	9	10	4,055	6,444	720	1,044	4,775	7,488	
Ujitja dhe Kullimi	2	2	590	965	90	154	680	1,119	
Administrimi i pyjeve	11	11	9,050	11,000	890	2,000	9,940	13,000	
Rruget Rurale	59	60	27,846	38,000	4,120	6,000	31,966	44,000	
Sherbimet publike vendore	35	55	18,035	32,600	2,826	5,211	20,861	37,811	
Programe kulturore dhe turistike	9	9	1,996	5,961	360	968	2,356	6,929	

Arsimi baze	102	104	71,571	81,000	12,212	10,032	83,783	91,032	
Arsimi mesem	4	4	2,994	3,000	417	840	3,412	3,840	
Qendra Ditore	8	10	4,319	4,802	572	959	4,891	5,761	
Cerdhja e Femijëve	23	24	11,873	14,280	2,057	2,310	13,930	16,590	
Shërbimi Zjarrfikës	16	16	11,111	16,985	1,259	3,000	12,370	19,985	
Gjendja Civile	6	6							
Menca Sociale	2			83		14		97	
Mbeshetje për të moshuarit				1,100		200		1,300	
<b>Totali</b>	<b>412</b>	<b>440</b>	<b>228,211</b>	<b>313,427</b>	<b>36,810</b>	<b>47,872</b>	<b>265,021</b>	<b>361,299</b>	<b>96,278</b>

Shpenzimet për paga janë në vlerën 313,427 mijë leke dhe zënë rreth 42% të buxhetit të vitit 2024. Shpenzimet për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në vlerën 47,872 mijë lekë dhe zënë rreth 6.4% të buxhetit.

Krahasuar me buxhetin e vitit 2023 shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë rritur me **96,278 mijë lekë** ose 36.3%. Kjo diferencë vjen si pasojë e rritjes së nivelit të pagave dhe ndryshimit të pages minimale si dhe rritjes së numrit të punonjësve.

## II. Shpenzimet operative

Bashkia Librazhd për vitin 2024 ka parashikuar shpenzime operative në vlerën 151,066 mijë lekë. Ky klasifikim ekonomik zë rreth 20% të buxhetit 2024. Konkretisht janë planifikuar shpenzime operative për të gjitha programet buxhetore. Krahasuar me vitin 2023 shpenzimet operative janë ulur me 3%.

## III. Transferime

Transferimet në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2024 janë në vlerën 16,000 mijë lekë dhe zënë rreth 2 % të totalit të Buxhetit. Konkretisht janë transferim për klubin e sportit "Sopot" 14,000 mijë lekë, transferim Këshillit të Qarkut Elbasan 2,000 mijë lekë.

## IV. Fondi për Ristrukturim

Fondi për restrukturim në buxhetin e vitit 2024 është në vlerën 12,348 mijë lekë dhe zë rreth 1.6% të totalit të buxhetit. Fondi për ndihmë financiare është 2,000 mijë lekë, bonus strehimi 3,000 mijë lekë, emergjenca civile është planifikuar 1% e totalit të transfertave dhe të ardhurat e veta të bashkisë në vlerën 7,348 mijë lekë.

## V. Fondi Rezervë/Kontigjence

Në buxhetin e vitit 2024 Fondi rezervë është në vlerën 14,695 mijë lekë dhe zë 2 % të totalit të buxhetit. Fondi Kontigjencës është planifikuar 2,000 mijë lekë.

# Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

PLANI I TE ARDHURAVE	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	175,506,000	179,420,000	187,559,000
Te ardhura tatimore	58,890,000	60,982,000	67,302,000
Te ardhura jo tatimore	116,616,000	118,438,000	120,257,000

Parashikimi i të ardhurave të Bashkisë për vitin 2024 është bërë duke u bazuar në ligjet : Ligjin Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore";

Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH "

Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;

VKM ,udhëzimet si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.108 ,date 30.11.2023 "Për Miratimin e Paketës Fiskale 2024 " dhe " konfirmim akti " nga Prefektura e Qarkut Elbasan .

## Në planifikimin e saktë të të ardhurave jemi bazuar :

- Në realizimin e të ardhurave faktike Janar – Nëntor 2023 ,i pritshmi Dhjetor 2023.
- Në nivelin e taksave dhe tarifave të përcaktuara sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak për cdo lloj aktiviteti , zone, përgjegjësie tatimore .
- Taksimi dhe tarifimi i subjekteve të licensuara është bërë mbi bazen e përgjegjësive tatimore.

Ky parashikim i të ardhurave të buxhetit të vitit 2024 synon sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve .

Plani i të ardhurave të Bashkisë Librazhd për vitin 2024 është në vlerën 175,506 mijë lekë ( Bashkëlidhur tabela Nr. 1 me planifikimin e të ardhurave për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2024 -2026 , tabela .

Bashkëlidhur tabela Nr .3 buxheti mujor për vitin 2024).

Për vitin 2024 plani i të ardhurave të bashkisë parashikohet në vlerën 175,506 mijë lekë i detajuar si më poshtë.

**Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 .**

/ 000 Lekë

Nr	Lloji i taksës e tarifës	Planifikimi Viti 2024
	<b><i>Të ardhura tatimore</i></b>	
	<b><i>Të ardhura nga taksat vendore</i></b>	
1	Tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël	320
2	Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale	10000
3	Taksa mbi ndërtesat	14000
4	Taksë mbi truallin	612
5	Taksë tokë bujqësore	5559
6	Taksa e kalim të drejtës së pronësisë	200
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërtimet e reja	10302
8	Taksa e ndikimit në infrastrukturë legalizimet	3000
9	Taksë tablele	355
10	Taksë hoteli	174
11	Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve	14000
12	Taksë nga Renta	368
		<b>58890</b>
	<b><i>Të ardhura jo tatimore</i></b>	
	<b><i>Të ardhura nga tarifatat vendore</i></b>	
1	Tarifë pastrimi	19500
2	Tarifë ndricimi+Gjelbrimi	3570
3	Tarifë sherbimi në varrezat publike	150
4	Tarifa e sherbimit veterinar	350
5	Tarife e tregut te organizuar	1250
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	36
7	Tarife parkimi	1326
8	Tarife per dhenie license e certifikate transporti	650
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione	150
10	Tarife per zenien e hapsires publike	2150
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	150
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	3000
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	1683
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430
15	Tarife per mbetjet inerte	10
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	7140



17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	101
18	Kamatvonesa	1500
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	19500
	<b>Shuma</b>	<b>62646</b>
	<b>Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave</b>	
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	23000
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	350
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	10000
4	Nga shfrytezimi i druve te zjarrit nga fshataresia	5600
5	Nga shfrytezimi i prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	300
6	Të ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	620
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	200
	<b>Shuma</b>	<b>40070</b>
	<b>Te ardhura te tjera</b>	
1	Qera e shitje trualli	0
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	467
3	Pagesa e prindërve çerdhe	2190
4	Pagesa e prindërve kopësht	7744
5	Detyrime te prapambeturanga kopshtet, çerdhe dhe qendra ditore	1849
6	Gjoha nga IMT ,dhe Policia Bashkiake	1600
7	Të ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	50
8	Sponsorizime	0
9	Tarifë akte ligjore e administrative, shitje skrap etj	0
	<b>Shuma</b>	<b>13900</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>175,506</b>

Të ardhurat për vitin 2024 janë planifikuar në masën 175,506 mijë lekë  
Më poshtë po shpjegojmë sipas zërave të të ardhurave .

### **Të ardhurat tatimore nga Taksat .**

**Taksa e Tatimit mbi të ardhurat personale** është planifikuar 10 mijlon lekë., planifikimi eshte bere mbi bazen e realizimit faktik 2023 .Planifikimi nga tatimi mbi të ardhurat është 2 % .

#### **Taksa mbi ndërtesat**

Janë planifikuar 90 mije m2 ndërtesa për njesi shërbimi , 211 mijë m2 apartament banini në qytet dhe 192 mijë m2 sipërfaqe ndërtese në 6 njësitë administrative .

Nga këto 90 mijë m<sup>2</sup> janë nga biznesi si në qytet ashtu edhe nga 6 njesite administrative ne vleren 9,800 mijë lekë , 403 mije m<sup>2</sup> në vlerën 6,200 mijë lekë për objektet për banim ( familjarët ).

Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë sipas Ligjit 9632, date 30.10.2006 i ndryshuar me ligjin , NR.106/2017, VKM ,Nr .132 ,date 07.03.2018 ku sipas këtij ligji baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës dhe kjo taksë aplikohet si përqindje mbi bazën e taksës , neni 21 , ku përcaktohet se Këshilli Bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për cdo kategori minimale të bazës së taksës, në kufijtë plus /minus 30 përqind të nivelit tregues taksës për kategoritë përkatëse.

Për taksën e ndërtesës për vitin 2024 është planifikuar 16000 mije lekë , nisur nga fakti i realizimit dhe grumbullimi i të dhënave për pronësitë .

Plani për 2024 është bazuar në realizimin faktik , pamvaresisht se eshte rregjistruar nje numer i konsiderueshem i siperfaqeve te ndertesave , si dhe siperfaqet e legalizuara te regjistruara ne ASHK, te verifikuara ne terren ka ndertesave pa u future new rregjistrin e taksapaguesve . Nga 81 mije m<sup>2</sup> sipërfaqe në vitin 2023 shkon në 90 mijë m<sup>2</sup> për vitin 2024.Mendojmë të rrisim bazën e taksueshme për ndërtesat ( numri i ndërtesave të taksueshme ).Sipërfaqet e ndërtesave për banim për vitin 2024 shkon 403 mije m<sup>2</sup> nga 288 mijë m<sup>2</sup> në vitin 2023.

**Taksa mbi truallin** për vitin 2024 është planifikuar në masën 600 mijë lekë që llogaritet truall funksional si në qytet ashtu dhe në gjashte Njesitë Administrative.

#### **Taksa mbi Tokën Bujqësore.**

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori dhe planifikimi për vitin 2024 është 5400 ha toke bujqësore ne vleren 5559 mijë leke nga 4500 ha tokë bujqësore në vlerën 5450 mijë lekë për vitin 2023.

#### **Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë.**

Për vitin 2024 është planifikuar në masën 200 mijë lekë taksa e kalimit të drejtës së pronësisë ,paguhet nga firmat ndërtuese , subjektet juridike që kryejnë transaksione të shitjes dhe nga informacioni i marrë nga ASHK.( nuk eshte marre fakti i realizimit te vitit 2023 eshte pasi ka qene nje vlere e mbartur e cila u arketua ne 2023 ).

#### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë , ndërtimet e reja**

Në këtë vlerë është përfshirë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, duke marrë per baze plani, kerkesat për leje ndërtimi . Për vitin 2024 është planifikuar 10,302 mijë lekë.

#### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet**

Në këtë vlerë është përfshirë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e trajtuara me leje legalizimi dhe për vitin 2024 është planifikuar 3 milion lekë kjo referuar vitin aktual që janë legalizuar nga ASHK .

#### **Taksa e tabelës**

Për vitin 2024 është planifikuar në masën 355 mijë lekë , bazuar kjo te subjektet që kanë vendosur tabelë si bankat, subjektet.Theksojmë se në bazë të ligjit për tabelën deri në 2 m<sup>2</sup> taksimi 0 dhe maximumi sipërfaqes është deri në 35 m<sup>2</sup> .

**Taksë Hoteli** për vitin 2024 është planifikuar në masën 174 mijë lekë për 7 subjekte Parashikimi bëhet duke marrë për bazë rregjistrin e bizneseve ku janë të regjistruara për cdo natë fjetje personi në hotel .

**Taksa e Regjistrimit të përvitshëm të Automjeteve** janë planifikuar me një vlerë 14000 mijë lekë duke marrë si bazë arkëtimet e vitit 2023 të regjistrimit të makinave për vitin 2023.nga taksa e regjistrimit , DTRR për bashkinë arkëton 25 % të vlerës .

#### **Taksa nga Renta**

Rentë paguajnë subjektet minerare që xhirohet 5 % e vleres së rentës nga dogana per importet dhe eksportet të minerareve , Kjo takesë është planifikuar 360 mijë lekë duke marrë si referencë dhe derdhjet e vitit 2023 .

**Tarifa e pastrimit.**

Tarifa e pastrimit përbën 11.1 % të planit të ardhurave të Bashkisë për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 19,500 mijë lekë. Pagesës për tarifën e pastrimit i nënshtrohen subjektet e biznesit të vogël, të madh, OJF , institucionet dhe familjarët, sipas niveleve të tarifave të përcaktuara në paketën fiskale, sipas Vendimit të Keshillit Bashkiak datë 30.11.2023 kategorizimeve përkatëse, të bazës së të dhënave të krijuara, për numrin e subjekteve të biznesit të vogël, të madh dhe institucioneve që ushtrojnë aktivitet, në teritorin e Bashkisë Librazhd, si dhe numrit të familjeve që banojnë brenda territorit të Bashkisë Librazhd që i nënshtrohen tarifës së pastrimit në shkëmbim të shërbimit të marrë .

*/000 leke*

1	Për cdo subjekt të biznesit të vogël të artikujve industriale , artikujve të ndryshëm kafe , bar- kafe, shërbime (këpucar , rrobaqepës , parukeri etj ).(+njesitë administrative )	260	1,820
2	Për cdo subjekt të biznesit të vogël që ndodhet në zonën pedonale ( zona A)	30	330
3	Për cdo subjekt të biznesit të vogël të artikujve ushqimore , fruta perime ,bulmet bar- restaurante , bujtina, profesione të lira, prodhim, shitje lëndë ndërtimi , inerte , ndërtim , projekte , zbatime, konsulence .	202	1,750
4	Për çdo subjekt të biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitet me një nipt dy aktivitetet në të njëjtën vendodhje .	9	144
5	Për niptet sekondare dhe subjektet e biznesit të madh që kanë seline në Bashkitë e tjera ( ose janë me kontratë të lidhur me Bashkinë Librazhd)	2	220
6	Për subjektet e biznesit të madh të regjistruar në regjistrin e biznesit, në zonën pedonale	1	440
7	Per biznesin e madh të regjistruar në regjistrin e biznesit, jashtë pedonale .	3	660
8	Per subjektet e biznesit të madh të regjistruar në regjistrin e biznesit si bankat .	4	880
9	Per cdo subjektet e biznesit të madh të regjistruar në regjistrin e biznesit si : fondacionet.	5	330
10	Për cdo njesi shitje të biznesit të madh	12	1056

	,ushqimore bar – restorant , baste sportive , hotele , motele bujtina .		
11	Për cdo subjekt i profesioneve te lira, farmaci , te biznesit te madh.	10	550
12	Për cdo njesi shitje te biznesit te madh materiale ndertimi, shitje lende drusore, industriale , kablllore , internet.	44	3,872
13	Për cdo njesi prodhimi te biznesit te madh, fasonet .	11	1,815
14	Për kompanite e sigurimit me nipte sekondare dhe subjektet e biznesit te madh qe kane vetem seline ne Bashkine Librazhd	2	55
15	Për cdo firme ndertimi per seline administrative Bashkia Librazhd	4	176
16	Për subjektet e transportit mallit te biznesit te madh.	4	132
17	Për subjektet e transportit te udhetareve te biznesit te madh.	4	110
18	Për cdo njesi shitje karburanti dhe gazi te lenget te biznesit te madh.	7	740
19	Për ndermarrjet dhe institucionet shteterore Për ndermarrjet dhe institucionet jo shteterore qe kryejne sherbime dhe realizojne te ardhura	21	1045
20	Për tregtaret brenda tregut me kontrate me Bashkine	20	2
21	Për OJF dhe shoqatat	6	40
22	Për ambulantët	15	30
23	Pastrimi, largim mbeturinash ( familjarët)	Qytet 1891+ 2900 njesi administrative	3,617
24	Pastrimi, largim mbeturinash, për familjet me ndihmë ekonomike, invalidet, të vetmuarit dhe veteranët e luftës.	Qytet 600 familje Njesi 200 familje	400
	<b>Shuma</b>		<b>19,500</b>

#### **Tarifa e Ndrimit dhe e Gjellbërimit**

Pagesës së tarifës së gjellbërimit dhe ndrcimit i nënshtrohen te gjithe subjektet e biznesit të vogël ,subjektet e biznesit të madh institucionet dhe familjarët,që ushtrojnë veprimtari ekonomike (për subjektet) në Njësinë Administrative Librazhd dhe familjarët e kësaj njësie.

Llogaritja e planit të tarifës së ndricimit dhe gjelbërimit për vitin 2024.

			Vlera/000
1	Per cdo subjekt te biznesit te vogel shitje, prodhim dhe sherbime transporte etj	350	454
2	Per cdo subjekt te biznesit te vogel ne pedonale, profesione te lira, prodhimi, projektim, konsulence, etj	95	475
3	Per cdo subjekt te biznesit te madh, institucionet shteterore dhe jo shteterore.	98	1370
3	Tarifa e ndricimit ,gjelberimit per cdo familje	2491	1025
5	Tarife ndricimi dhe gjelberimit per familje me ndihme ekonomike, invalidet, (kane 1 pjesetar te familjes) te vetmuarit	615	246
<b>Shuma</b>			<b>3,570</b>

#### **Tarifë për zënien e hapësirës publike.**

Tarifën e paguajnë të gjithë bizneset që shfytëzojnë hapësirat publike jashtë objektit të regjistruar me çertifikatë pronësie . Për vitin 2024 planifikohet vlera prej 2 milion 150 mijë lekë si më poshtë ;

Biznese në pedonale , karburante , biznese në zonën “c” dhe njësitë administrative janë 1200 m2 sipërfaqe hapësire publike .

#### **Tarifë për mbetjet inerte**

Planifikimi për vitin 2024 është 10 mijë lekë për subjektet që mbetjet mbas ndërtineve ti hedhin në venddepozitimet e përcaktuara sipas VKB .Plani është bazuar në realizimin faktik 2023 pasi nuk ka patur arkëtime pamvarësisht kontratave të lidhura .

#### **Tarifë shërbimi në varrezat publike**

Për vitin 2024 janë planifikuar 150 mijë lekë për 2 subjektet që kryejnë aktivitetet të tillë . Informacioni është marrë nga zyra e gjendjes civile për vitin 2023.

#### **Tarifa e shërbimit veterinar**

Për vitin 2024 planifikimi është 350 mijë lekë, është bërë në bazë të regjistrit që administrohet nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan me numër kërresh për të imta dhe të trasha për periudhën Janar – Tetor 2023.

#### **Tarifë e tregut të organizuar**

Kjo taksë realizohet nëpërmjet vjeljes së të ardhurave mujore për tregtarët që tregtojnë brenda tregut sipas kontratave vjetore për vendet e zëna në tregun e qytetit ku për vitin 2023 janë lidhur 20 kontrata . Gjithashtu të ardhurat nga biletat ditore për tregtarët që tregtojnë jashtë kabanoneve të tregut,të cilët i nënshtrohen biletës ditore.

ne/ 000leke

Nr	Emertimi	Planifikimi
1	Tregtare me kontrate	382
2	Tregu ditor me bileta	868
	<b>Shuma</b>	<b>1,250</b>

### Tarifa leje për tregëtim ambulatorë

Kjo e ardhur vjen nga tregtarët ambulatorë që marrin leje për ushtrim aktiviteti , aktualisht janë 14 subjekte ambulatorë .

Emertimi	Numer	Vlera / 000leke
Leje ambulatorë	12	36

Numri i lejeve ambulatorë aktualisht është 12 subjekte .

### Tarifa e parkimit

Tarifën e parkimit e paguajnë të gjithë subjektet e transportit ne territorin e Njesise Administrative Librazhd.

Subjekte transporti per linjat rrethqytetase kemi 45

Subjekte transporti per linjat nderqytetase kemi 3

Subjekte transporti per lic. Takxi 10 (4+1 dhe 8+1) .

/000 leke

Tarife parkimi nga biznesi i madh	420
Tarife parkimi nga biznesi i vogel	286
Tarife parkimi nga linjat pritese dhe linjat rrethqytetese dhe taksite	405
Parkim rezident	300
<b>Shuma</b>	<b>1,326</b>

Kjo tarfië aplikohet për çdo subjekt të biznesit të vogël e të madh,instituconet,si dhe parkim të rezervuar dhe rezident sipas kërkesës së subjekteve dhe familjareve .

Si dhe per linjet e transportit rrethqytetese, që parkojnë makinat në terminal .

Gjithashtu parkim paguajnë dhe linjat ndërqytetase që parkojnë në terminal .

Është planifikuar për vitin 2024 në vlerën 1326 mijë lekë , e cila mblidhet nga Njësia Administrative Librazhd,sepse dhe shërbimi për dhënie liçense dhe çertifikatë në fushën e transportit të mallrave dhe udhëtareve, kryhet nga e Njësise Administrative Librazhd.

### Tarifë për dhënie liçense e çertifikate transporti

Është planifikuar në vlerën 500 mijë lekë për subjektet e transportit rrethqytetas që liçensohen nga bashkia e paisen me liçensë e çertifikate transporti .Për 45 subjekte transporti rinovim i liçensave dhe çertifikatë transporti për vitin 2024.

**Tarifa për autorizime ushtrim aktiviteti per subjektet dhe mjetet e tjera që furnizojnë dyqanet me produkte e mallra .**

Planifikimi është bërë për autorizimet që do të paisen subjektet për tu futur në qytet në Bashkinë Librazhd për furnizimin me produkte në subjektet e bizneseve .

Tarifa për leje edhe ushtrim aktiviteti janë planifikuar për subjekte private të cilët funksionojnë dhe si tabakino.

### **Tarifat për dhënien e Licenave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve te saj**

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Librazhd .

Për vitin 2024 janë planifikuar 3 subjekte për tu paisur me autorizim / license në vlerën 3 mijlon lekë .

### **Tarifë për librat e udhëtimit të udhëtarëve brenda vendit**

Të ardhurat e planifikuara nga librat e udhëtimit që merren nga subjektet e transportit dhe përdoren për të dalë nga linja e miratuar e liënsimit të tyre për vitin 2024 .Plani është 150 mijë lekë .Subjektet e transportit paisen nga Bashkia me libra udhëtimi per të transportuar udhëtare jashtë juridiksionit të Bashkisë .

### **Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore**

Planifikimi për subjektet e linjave ajrore e nëntokësore për vitin 2024 në vleren 430 mijë lekë .Tarifës për shfrytëzim të truallit publik për kabllot telefonike,tv kabllor,fibra optike(nëntokësor dhe ajrore) i nënshtrohen 4 subjekte të biznesit të madh dhe një subjekt i vogël .

### **Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit**

<b>Nr.</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Vlera /000 lekë</b>
<b>1.</b>	Subjektet persona juridik/fizike që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrire guri (gurore), pasurimit te mineraleve, veprimtari prodhese te cila proceset e tyre shoqerohen me shkarkim te gazrave, minierat, trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, dhe veprimtari te tjera te ngjashme 2 subjek	240
<b>2.</b>	Subjektet persona juridik/fizike ne fushen e prodhimit te energjise (HEC)( 20 subjekte )	6600
<b>3</b>	Subjektet persona juridik/fizike që ushtrojnë aktivitet të tillë si: tregtim te hidrokarbureve ( pesë subjekte )	300
	<b>Shuma</b>	<b>7,140</b>

Planifikimi i kësaj tarife është për subjektet minerare , karburantet , gurore ,prodhim energjie , subjektet e mbetjeve plastike .

### **Detyrime të prapmbetura nga taksat**

Ne baze te ligjit 68/2017 per financat e vetqeverisjes vendore detyrimet tatimore të pambledhura në kohë prej më shumë se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore nuk përfshihen në parashikimin e të ardhuarve dhe shpenzimeve në projekt buxhetin për vitin buxhetor pasardhës.

Në këtë zë janë planifikuar detyrimet e subjekteve që janë debitore ndaj Bashkisë Librazhd, të evidentuar dhe kontabilizuar nga zyra e Taksave dhe financës dhe për të cilat do të shfrytëzohen të gjithë hapësirat ligjore për arkëtimin e tyre.

Detyrimet për vitin 2024 janë parashikuar që të mblidhen 19,500 mijë lekë ( për bizneset dhe familjarët ).

( Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave )

#### **Tarifë në sektorin e pyjeve dhe kullotave për vitin 2024**

Tarifa e dhënies në përdorim e fondit pyjor është planifikuar me rritje plani , kjo për arsye se me kalimin e pronave në pronësi të Bashkisë dhe regjistrimit në ASHK , bashkia plotëson kriteret për të dhënë në përdorim sipërfaqe për veprimtaritë e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Tarifa nga shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet për vitin 2024 është planifikuar ulje , kjo për arsye se disa prej kontratave të konçensioneve kanë mbaruar këstet e pagesës. Për vitet 2025, 2026 janë parashikuar rritje për faktin se bashkia mund të shesë në popullatë materialin drusor, dru zjarri për ngrohje se duke llogaritur kostot , mendojmë se mund të kemi të ardhura .

Planifikimi në total i të ardhurave nga sektori i pyjeve dhe kullotave për vitin 2024 është 40,070 mijë lekë .

( Drejtoria e Buxhetit dhe Financës )

**Të ardhura nga qera dhe shitje trualli** për vitet 2024-2026 nuk ka .

Të ardhura nga privatizimet për vitin 2024 planifikimi është 467 mijë lekë , sipas kontratave të lidhura me Bashkinë e afatit të përcaktuar në kontratë.

Të ardhura nga pagesat e prindërve në çerdhe janë 2,190 mijë lekë

Të ardhura nga pagesat e prindërve në kopësht janë 7,744 mijë lekë

Të ardhura nga detyrimet e prapambetura nga çerdhe dhe kopësht janë në vlerën 1,849 mijë lekë.

#### **Efektet financiarë që pasqyrohet nga ndryshimet në paketën fiskale 2024 për taksat e tarifave vendore janë si më poshtë :**

Kemi ndryshime në taksat

##### Shtesa në planifikim

- 1- Taksë trualli , rritje plani në vlerën 12 mijë lekë
- 2- Tokën bujqësore, rritje plani në vlerën 109 mijë lekë
- 3- Taksat e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi rritje plani në vlerën 5202 mijë lekë
- 4- Taksat e hotelierisë rritje me 4 mijë lekë.
- 5- Taksat e rente rritje me 8 mijë lekë
- 6- Tarifet pastrimi kemi rritje në vlerën 500 mijë lekë .
- 7- Tarifet ndricim gjelberimi kemi rritje në vlerën 70 mijë lekë
- 8- Tarifet sherbimi publike kemi rritje në vlerën 30 mijë lekë
- 9- Tarifet sherbimi veterinar kemi rritje në vlerën 150 mijë lekë
- 10- Tarifet e tregut qytet kemi rritje në vlerën 50 mijë lekë
- 11- Tarifet parkimi kemi rritje në vlerën 26 mijë lekë
- 12- Tarifet licensimi kemi rritje në vlerën 150 mijë lekë
- 13- Tarifet autorizim për karburantet kemi rritje në vlerën 1,000 mijë lekë
- 14- Te tjera nga urbanistika kemi rritje në vlerën 33 mijë lekë
- 15- Tarifet ndikimi në mjedis kemi rritje në vlerën 140 mijë lekë
- 16- Detyrim i prapambetur nga taksat kemi rritje në vlerën 500 mijë lekë



- 17- Tarife ne sektorin e pyjeve kemi rritje në vlerën 10,300 mijë lekë
- 18- Qera ndertese nga privatizimet kemi rritje në vlerën 97 mijë lekë
- 19- Pagesat e prindërve në çerdhe kemi rritje në vlerën 790 mijë lekë
- 20- Pagesat e prindërve në kopesht kemi rritje në vlerën 2,604 mijë lekë
- 21- Detyrim i prapambetur nga çerdhe e kopështi, qendra ditore kemi rritje në vlerën 933 mijë lekë .

Ulje në planifikim

- 1- Taksë ndërtese ulje në vlerën 2,000 mijë lekë
- 2- Taksë kalimi it e drejtes s e pronesise ulje në vlerën 600 mijë lekë
- 3- Taksë takes tablele ulje në vlerën 265 mijë lekë
- 4- Taksë regjistrimi i pervitshem te automjeteve ulje në vlerën 500 mijë lekë
- 5- Tarifë për tregtim ambulator ulje në vlerën 24 mijë lekë
- 6- Tarifë për leje të drejta autorizime ulje në vlerën 600 mijë lekë .
- 7- Tarifë për mbetjet inerte ulje në vlerën 200 mijë lekë
- 8- Tarifë për shfrytezimin e materialit drusor nga subjektet ulje në vlerën 11500 mijë lekë
- 9- Qera e shitje trualli ulje në vlerën 600 mijë lekë
- 10- Gjoba nga IMT dhe Policia Bashkiake , ulje në vlerën 650 mijë lekë
- 11- Të ardhurat nga pulla , ulje në vlerën 25 mijë lekë

***Në total efekti rritës i Planifikimit Buxhetor 2024 është 5,745 mijë lekë ose 3.39% më shumë se viti 2023 .***

Në përfundim të këtij relacioni mendojmë se planifikimi i të ardhurave dhe realizimi i tyre gjatë vitit 2024 do të jetë faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe përmbushjen e funksioneve të Bashkisë ndaj Komunitetit.

# Investimet

*Investimet për vitin 2024 zënë 25 % të totalit të buxhetit. Nga këto:*

➤ **Investimet në proces**

Investimet në proces në buxhetin e vitit 2024 janë në vlerën 110,916,468 lekë dhe zënë rreth 15% të buxhetit të vitit 2024. Krahasuar me vitin 2023 investimet në proces janë rritur.

Nr.	EMERTIMI I INVESTIMIT	VLERA E PLOTE E PROJEKTI	VLERA E KONTRATËS	FINANCIMI				GR. TITULL. KAPITULL	GRANT	TR. Pakushtezuar sektoriale	TE ARDHURA
				VITI 2022	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025				
1	Rikonstruksion i rrugës Krashtë Gizavesh bashkia Librazhd	118,206,786	69,019,363	20,710,011	20,000,000	28,309,352		0 5 4520 231			28,309,352
2	Sistemi asfaltim i rrugës së fshatit Çerçan Nj. Hotolisht	49,376,842	36,261,733		31,068,213	5,193,520		0 5 4520 231			5,193,520
3	Rikonstruksion i rrugës Mirakë-Gjovaç Nj. Adm. Polis	63,278,532	46,800,089		22,092,020	21,186,512	3,521,557	0 1 4520 231	21,186,512		
4	Mbikqyrje Rikonstruksion i rrugës Mirakë-Gjovaç Nj. Adm. Polis	1,021,768	902,528		200,000	400,000	302,528	0 1 1110 231	400,000		
5	Ndërtim Central Park (Parku Qëndror)Faza II B.Librazhd	40,611,147	32,445,135		20,611,147	11,833,988		0 1 4520 231	11,833,988		
6	Sistemi asfaltim i rrugës Spathar(Loti I) B.Librazhd	99,988,926	66,858,494		40,094,624	20,000,000	6,763,870	0 5 4520 231			20,000,000
7	Rikonstruksion kanali Roçit ,Nj. Hotolisht ,kanali Orenjë Fioq Kanali Letëm (Geshthenjë në vazhdim) kanali kullues Studën	18,600,000	14,383,270		10,397,530	3,985,740		0 1 4240 231		3,985,740	
8	Mbikqyrje Ndërtim central park (Qëndror)faza II	1,011,916	925,151		413,234	511,917		0 1 1110 231	511,917		

9	Mbikqyrje Sistemit asfaltim i rrugës së fshatit Spathar (Loti I) Mbikqyrje Rikonstrukcion kanali Roçit Nj. Adm Hotolisht kanali Orenjë Floq, Kanali Letëm (Geshienjë në vazhdim) kanali kullues Studën	1,191,197	1,068,034			200,000	300,000	568,034	0 1 1110 231	300,000		
10	Sistemit asfaltim i rrugës fshatit Kokrevë faza I-rë Nj. Adm Hotolisht Bashkia Librazhd	556,326	510,030			240,000	270,030		0 1 1110 231	270,030		
11	Mbikqyrje Sistemit asfaltim i rrugës fshatit Kokrevë faza I-rë Nj. Hotolisht Bashkia Librazhd	99,884,423	71,747,177			29,500,000	9,116,745	33,130,432	0 1 4520 231	9,116,745		
12	Bashkëfinancim Ndërtim i shkollës së mesme Polis+Palester Nj, Polis	1,190,918	1,066,901			99,999	199,999	766,903	0 1 1110 231	199,999		
13	Mbikqyrje Ndërtim i shkollës së mesme Polis+Palester Nj, Polis	16,766,421	15,600,687			2,514,960	7,125,720	5,960,007	0 1 9120 231	7,125,720		
14	Bashkëfinancim Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara	1,173,940	1,173,940			200,000	300,000	673,940	0 1 1110 231	300,000		
15		6,228,507	5,920,049			3,737,104	2,182,945		0 1 1110 231	2,182,945		
	<b>TOTALI</b>	<b>519,087,649</b>	<b>364,682,581</b>	<b>20,710,011</b>	<b>181,368,831</b>	<b>110,916,468</b>	<b>51,687,271</b>	<b>3,985,740</b>	<b>53,427,856</b>	<b>53,502,872</b>		

➤ **Investimet 2024**

Investimet për vitin 2024 janë planifikuar në vlerën **338,256,395 lekë** me financim në tre vite buxhetor ;

- Për vitin 2024 financimido të jetë në vlerën 113,875,250 lekë ose 14.5% të totalit të buxhetit 2024.
- Për vitin 2025 financimi do të jetë në vlerën 96,294,340 lekë.
- Për vitin 2026 financimi do të jetë në vlerën 128,086,805 lekë.

Nr	EMERTIMI PROJEKTT	VLERA E PLOTE E PROJEKTT	FINANCIMI NE VITE			PROGRAMI BUXHETOR	GRANT	Transferta e pakushëzuar sektoriale	TE ARDHURA
			VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026				
1	Mbikqyrje kolaudime	4,000,000	4,000,000			0 1 1110 231	4,000,000		
2	Blerje pajisje elektronike	2,000,000	2,000,000			0 5 1110 231			2,000,000
3	Studime projekte /oponence teknike	15,000,000	15,000,000			0 5 1110 230			15,000,000
4	Shpronësime	4,000,000	4,000,000			0 5 1110 231			4,000,000
5	Blerje mobilje e pajisje zyre	600,000	600,000			0 1 1110 231	600,000		

6	Rikonstruksion i rrugeve rurale dhe veprave te artit te Bashkise Librazhd	12,000,000	6,000,000	6,000,000		0 5 4520 231				6,000,000
7	Blerje tuba per kanalet vaditese	2,400,000	2,400,000			0 1 4240 231			2,400,000	
8	Riparime te pjeshme ne kanalet vaditese ne bashkine Librazhd	4,500,000	4,500,000			0 1 4240 231			4,500,000	
9	Riparim prita lumore Mirakë - Plane	1,000,000	1,000,000			0 1 4240 231			1,000,000	
10	Rikonstruksion Kanali I Kuturmanit	5,000,000	5,000,000			4240 231			1,481,683	3,518,317
11	Rikonstruksion Kanali Allanit Dorez (FZI: Hyrja + Skeja e ne Vazhdim )	5,000,000	3,000,000	2,000,000		0 1 4240 231				3,000,000
12	Hartim plani mbareshtimi Librazhd,Klenje,Prodan	3,000,000	3,000,000			0 5 4260 231				3,000,000
13	Pyllezime (pisha e zeze,geshtenje,akacie)	2,050,000	2,050,000			0 5 4260 231				2,050,000
14	Riparim lere ne ekonomine pyjore Mal Plak	700,000	700,000			0 5 4260 231				700,000
15	Bashkëfinancim per rikonstruksionin e qendres komunitare Multi Funktionale Kia Green Light Project	3,886,395	3,886,395			0 1 10430 231		3,886,395		
16	Sistemim asfaltim I rruges se Fshatit Librazhd Katund,Faza e I-re,Njesia Administrative Qender,Bashkia Librazhd.	90,000,000	20,000,000	41,647,170	28,352,830	4520 231			11,647,170	8,352,830
17	Sistemim asfaltim I rruges Funares-Zdrash ,Njesia Administrative Orenje ,Bashkia Librazhd	90,000,000	19,800,000	30,000,000	40,200,000	4520 231			11,500,000	8,300,000
18	Sistemim asfaltim I rruges se Fshatit Vecan ,faza e I-re,Njesia Administrative Hotolisht,Bashkia Librazhd	93,120,000	16,938,855	16,647,170	59,533,975	0 1 4520 231			16,938,855	
<b>TOTALI I INVESTIMEVE TE REJA PER VITIN 2024</b>		338,256,395	113,875,250	96,294,340	128,086,805	-		48,572,420	9,381,683	55,921,147

Ne kuader te permiresimit te infrastruktures rrugore rurale te Bashkise Librazhd, zhvillimit urban, kerkesat e banoreve dhe kerkesat e administratoreve te njesive administrative jane evidentuar objektet per investime prioritare si me poshte

***Sistemim asfaltim I rruges së fshatit Librazhd – Katund, faza I, Nj.Ad Qendër***

Kjo rruge i sherben ne menyre direkte banoreve te ketij fshati. Eshte rruge kryesore qe lidh rrugen e qytetit te Librazhd me ate te fshatit . Pjesa e rruges Librazhd - Katund është relativisht në gjendje mjaft të keqe ka nevojë për ndërhyrje të plotë. Rruga eshte e pa asfaltuar , e shtruar me kalldrëm ose rrugë dheri. Rruga lidh disa fshatra me njeri-tjetrin. Zhvillimi ne keto fshatra eshte penguar nga mungesa e infrastruktures. Fshatrat Librazhd-Qender, Librazhd –Katund, Lagjia Lugjet e Hyses jane fshatra qe lidhen me te njetin segment rrugor , rruge e cila eshte e parikonstruktuar. Asfaltimi i rruges qe lidh keto fshatra eshte domosdoshmeri edhe per faktin e zhvillimit turistik te zones por edhe per lehtesimin e jeteses se banoreve. Ne keto fshatra banojne rreth 1500 banore. Bashkia Librazhd ne mungese fondesh e ka patur te pamundur asfaltimin e rruges Librazhd-Qender- Librazhd- Katund- Qarrishte. Vlera e investimin është 90,000,000 lekë

***Asfaltim i rruges Funares –Zdrajsh, Loti III Njesia Adm Orenje***

Ky segment rrugor fillon nga fshati Funarës dhe vazhdon deri në qendrën e fshatit Zdranjsh. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është në gjendje të amortizuar për shkak të viteve dhe mirëmbajtjes së ulët. E gjithë gjatësia e rruges është me zhavor por faktorët atmosferikë kanë sjellë deformimin e trupit të rruges. Vlera e këtij projekti është 90,000,000 lekë.

***Rikonstrukcion I kanalit vaditës të Allanit Gizvesh Dorëz***

Kanali I Allanit me një gjatësi prej 11106 m dhe mbulon me vaditje fshatin Gizavesh, Dorëz dhe Librazhd-Qendër. Gjendja fizike aktuale e kanalit është shumë e amortizuar dhe vende vende e dëmtuar si pasojë e rrëshqitjeve dhe dëmevë të ndryshme të faktorëve atmosferikë. Vlera e investimit eshte 5,000,000 leke.

***Riparime te pjesshme ne kanalet vaditëse në bashkinë Librazhd***

Ne referim te detyres se projektimit, qëllimi i projektit konsiston në rikualifikimin e elementëve të kanaleve, krijimin e kushteve më të pershatateshme për funksionimin e këtyre kanaleve si infrastrukturë e mirëfilltë bashkëkohore ne sherbim te nje bujqesie te avancuar dhe kthimin e tyre ne vepra në shërbim të plote te komunitetit. Ndërhyrjet e parashikuara ne keto kanale nga grupi I projektimit , krijojne mundesine qe kanalet ne fjale te jene gjate gjithe periudhes se vaditjes te shfrytezueshme , te sigurt dhe te qendrueshme fizikisht dhe estetikisht , te konceptuar sipas standarteve bashkekohore , duke rritur keshtu cilësinë e sherbimeve bujqesore dhe permiresimin e jetës së banorëve. Përfituesit direkt të projektit janë rreth 800 banorë te zonave ku ndodhen kanalet , ose mbi 200 familje qe kane lidhje direct me sherbimet bujqesore qe kane te bejne me shfryrtezimin e ketyre kanaleve , object I cili eshte destinacioni terminal I permiresimit te rrjetit ujites per te cilen hartohet ky projekt. Vlera e investimit eshte 4,500,000 leke.

***Rikonstrukcion i rrugëve rurale dhe veprave te artit të bashkisë Librazhd***

Qellimi i ketij projekti eshte rehabilitimi i segmenteve rrugore te rrezikshme ne fshatrat e bashkise Librazhd nepermjet veprave te artit dhe ndertimit te shtresave rrugore te qendrueshme pasi gjate dimrit kushtet atmosferike çojne ne amortizimin e disa prej segmenteve rrugore. Vlera e investimit është 12,000,000 lekë.

***Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Vehcan, faza I, Nj.A Hotolisht***

Bashkia Librazhd ne kuader te permiresimit te infrastruktures ka menduar qe ne listen prioritare te jete edhe sistemimi i rruges Vehcan. Kjo rruge konsistohet rruge rurale me shtresa rrugore qe perbehen vetem nga formacione te dherave te zones, dhe ne disa segmente edhe shtresa me kalldrem, pa sisteme te largimit te ujrave te shiut. Rruga eshte e ngushte me gjeresi deri ne 3 m. Ky segment rrugor kalon neper nje terren te thyer malor. Investimi eshte 93,120,000 leke.

### **Riparim prita lumore Mirakë- Plane**

Vendodhja e objektit është në fshatin Polis Sheh dhe Polis Gostime, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd. Aktualisht në segmentin që propozohet kjo ndërhyrje është vazhdim i një investimi të realizuar në vitin 2021. Investimi i realizuar është i llojit pritë lumore me gabiona që mbron një pjesë të tokave bujqësore por edhe rrugën auto Polis-Gostime dhe Polis-Sheh.

Gjendja fizike në terren paraqitet e vështirë. Rreshjet e shiut me intesitet të lartë sollën prurje të larta nga përroi Sheh në këtë zonë të shoqëruara me materiale inerte dhe aluvione nga pjerrësia e shpatit të malit depërtuan në rrugë, banesa dhe toka bujqësore duke dëmtuar infrastruksurën rrugore, prita lumore e tokat bujqësore. Vlera e këtij projekti është 1,000,000 lekë.

### **Rikonstruksion Kanali i Kuturmanit**

Rikonstruksion kanali Kuturmanit, segmenti Kujtila-Kamolli. Kjo pjese kanali ka qene planifikuar edhe me pare per investim pasi mbulon me ujitje rreth 30 ha toke, shumica e mbjelle me peme, kryesisht qersh. Uji ne kete segment nuk kalon prej vitesh. Vlera e investimit është 5,000,000 lekë.

### **Blerje tuba per kanalet Vaditese**

Sistemi vadites duke qene faktor kyc ne bujqesi, lind nevoja per investim te herepashershem dhe mirebajtje te objekteve si kanalet vaditese etj. Vlera e projektit është 2,400,000 lekë.

### **Shpronesime**

Ne projektet e propozuara per zhvillim ne bashkine Librazhd, ekziston prania e objekteve apo e pronave qe kerkojne shpronesim. Per te mos u bere pengese e zhvillimit te projektit, ne rastet kur ekziston mundesia e realizimit te shpronesimit, lind nevoja e parashikimit ne p/buxhet te ketij zeri. Vlera e shpronesimeve eshte 4,000,000 leke.

## **Grupi i Menaxhimit Strategjik**

**Bajram Pishkashi**

**Ermir Sulollari**

**Manjola Omeri**

**Aferdita Alla**

**Klodian Burgjia**

**Lindita Shuli**

**Aleksander Brazhda**

**Hysni Hoxha**

**Erdis Alikaj**

**Valentin Kurti**

**Nadire Biçaku**

**Çlirim Vasku**